

XVI. VETËQEVERISJA LOKALE

NOCIONET KRYESORE:

Vetëqeverisja lokale; decentralizimi; dekoncentrimi; fushëveprimi; fushëveprimi i jashtëzakonshëm; fushëveprimi i deleguar (fushëveprimi i besueshëm); parimi i subsidiaritetit; ndarja territoriale; organet lokale; decentralizimi fiskal; referendum; iniciativa qytetare; tubim i qytetarëve.

PYETJE :

1. Çka është vetëqeverisje lokale ?
2. Çka bie në fushëveprimin e vetëqeverisjes lokale ?
3. Çfarë metode për përcaktimin e ndarjes territoriale të shtetit në njësi lokale parasheh Konventa Evropiane për ndarjen e vetëqeverisjes lokale?
4. Si mund të jenë të rregulluara marrëdhëniet në mes të organeve të shtetit dhe vetëqeverisjes lokale ?
5. Si realizohet financimi i njësive të vetëqeverisjes lokale ?
6. Sqaroni të drejtën e lidhjes në pushtetin lokal ?
7. Cilat janë elementet e vetëqeverisjes lokale ?
8. Cilat janë karakteristikat themelore të Konventës Evropiane për vetëqeverisje lokale?
9. Çfarë llojesh të kompetencave parasheh Konventa ?
10. Cfarë parasheh Konventa gjatë ndryshimit të kufijve të komunave ?
11. Çfarë llojesh të mbikqyrjeve parasheh Konventa ?
12. Si realizohet monitoringu për ndryshimin e parimeve të Konventës së vendeve pjesëmarrëse ?
13. A është vetëqeverisja lokale materie kushtetuse ?
14. Sa shkallë ka vetëqeverisja lokale në RM ?
15. Çka dini për simbolet e komunës ?
16. Kush është akti themelor juridik dhe çka regullon ai?
17. Kush janë kriteret gjatë përcaktimit të territorit të komunës ?
18. Çfarë llojesh të kompetencave kanë komunat në RM ?
19. Kush mund të ngrejë iniciativë qytetare, tubim të qytetarëve dhe referendum?
20. Kush e thirr tubimin e qytetarëve ?
21. Kur këshilli i komunës është i detyruar të shpallë referendum ?
22. Si është organizimi i komunave në Maqedoni ?
23. A është e mundur që kryetari dhe anëtarët e këshillit të revokohen ?
24. Për çka është kompetent Këshilli dhe për çka kryetari ?
25. Sqaroni rolin e Komisionit për marrëdhënie në mes të bashkësive ?
26. Si financohen komunat ?
27. Kush e bënë mbikqyrjen e punës së organeve komunale dhe si?
28. Cilat janë gjuhët zyrtare në komunë ?
29. Çfarë llojesh të mbrojtjeve të vetëqeverisjeve lokale ekzistojnë ?

1. Nocioni dhe elementet themelore të vetëqeverisjes lokale

Vetëqeverisja lokale paraqet formë të udhëheqjes së bashkësive lokale ku qytetarët, direkt ose nëpërmjet përfaqësuesve që i zgjedhin vetë, vendosin për interesat dhe punët me rëndësi lokale.

Elementet e vetëqeverisjes lokale janë :

1. Si formë politike e bashkësive lokale ajo pa dyshim është kategori e sistemit politik, ndërsa deri diku edhe e të drejtës kushtetuese.
2. Ajo është shprehja e të drejtës së popullsisë në bashkësi të caktuara që pavarësisht të udhëheqin me punët të lidhura me locus-in.
3. Ajo parimisht është institut demokratik, shumë me rëndësi për demokratizimin e sistemit politik.
4. Ajo i dedikohet bashkësisë së caktuar sociologjike.
5. Atë e karakterizojnë karakteristika të caktuara organizative pa të cilat nuk ka vetëqeverisje lokale :
 - Popullsia e një territori të caktuar lokal *vetë i zgjedh organet e veta të udhëheqjes*;
 - Popullsia direkt ose nëpërmjet organeve të tyre i kryen funksionet e pushtetit lokal dhe të gjitha funksionet e tjera të lidhura me bashkësitë lokale (*kompetenca vendore*);
 - Organi përfaqësues ka *kompetencën e vet të vërtetë*, ku me realizimin e saj ndikon në jetën e bashkësisë ;
 - Organi përfaqësues *zgjedh organet dhe institutet e veta* ;
 - Vetëqeverisja lokale ka *mbështetjen e vet materiale* ;
 - Marrëdhëniet e organeve më të larta dhe qëndrore janë të themeluara me kushtetutë dhe me ligj. Ato së pari janë të krijuara për vlerësimin e ligjëshmërisë së punës të organeve, ndërsa vetëm në pjesën e deleguar edhe vlerësimin e punës së përgjithshme.¹

Sistemet bashkëkohore politike pretendojnë që ndarja e njësive territoriale e shtetit, gjegjësisht udhëheqja lokale, më shumë të përputhet me bashkësinë lokale si bashkësi reale në kuptimin social. Prandaj, zgjidhje ideale është, atje ku është e mundur, vetëqeverisja lokale të përputhet me vendbanimin, me pjesët e vendbanimit, gjegjësisht me disa vendbanime të lidhura si bashkësi reale.

Në shoqëritë e zhvilluara vazhdimisht rritet numri i shërbimeve dhe organizatave profesionale të cilat kënaqin një numër më të madh të nevojave të banorëve në hapësirën lokale, të cilët dikur i kanë kryer me aktivitet personal. Shteti i "tërrsishëm" mundohet që më shumë centralisht "t'i kryejë" problemet lokale dhe bashkësia lokale dhe vetëqeverisja lokale të jenë vetëm forma më të ulëta të ndarjes administrativo-territoriale të shtetit. Por, Evropa bashkëkohore mbrohet nga centarlizimi me nxitjen e vetëqeverisjes lokale dhe decentralizimin.

¹ Për këtë më gjerë të : d-r G. Siljanovska-Davkova : "Komuna në mes normës dhe realitetit", Disertacion i mbrojtur në Fakultetin juridik të Ljubljanes, 1993, faq.35,36,37.

2. Konventa Evropiane e vetëqeverisjes lokale – “Magna Carta” e demokracisë lokale

2.1. Nga ideja deri në konventë

Vetëqeverisja lokale e zhvilluar është “*conditio sine qua non*” e Evropës së integruar, moderne dhe demokratike. Vitet e shtatëdhjeta dhe fillimi i viteve të tetëdhjeta të shekullit që kaloi janë vite të renesansës lokale. Evropën e kaploi një valë e reformave lokale në drejtim të përforsimit të pushtetit lokal prerogativ dhe financimi i mbështetur i tyre. Kulmi i serive të intervenimeve, rezolutave dhe projekt-dokumenteve është personifikuar në Konventën Evropiane për vetëqeverisje lokale e vitit 1985. Deri më 20.11.1998 Kontratën e kanë nënshkruar 36 vende, ndërsa e ratifikuan 30 vende. Republika e Maqedonisë e nënshkroi më 14.06.1996, ndërsa e ratifikoi më 06.06.1997. Më 01.10.1997 Konventa hyri në fuqi.

2.2. Karakteristikat e përgjithshme

Konventa e vetëqeverisjes lokale vlen për instrumentin modern, pragmatik, fleksibil, afatgjatë juridik i cili duhet t’i mbrojë të drejtat e pushtetit lokal si më të afërta me qytetarët dhe t’u ofrojë pjesëmarrje efektive dhe të gjerë në zgjedhjen e problemeve lokale d.m.th. në jetën lokale publike. Si instrument juridik multilateral i cili garanton shkallë të lartë të autonomisë lokale, Konventa është njëra nga shtyllat më të rëndësishme të integritimit dhe demokratizimit evropian.

2.3. Për Konventën konkretisht

Është e përbërë nga Preambula dhe tri pjesë.

Pjesa e parë e trajton : bazën kushtetuese dhe ligjore të vetëqeverisjes lokale (neni 2); Koncepti i vetëqeverisjes lokale (neni3), fushëveprimi (neni 4); mbrojtja e kufijve të bashkësive lokale (neni 5); organizimi I administratës dhe burimet e mjeteve për kryerjen e punëve (neni6); kushtet për kryerjen e aktiviteteve (neni7); mbikqyrja e punës (neni 8) ; burimet financiare (neni 9); e drejta e lidhjes (neni 10); mbrojtja ligjore e vetëqeverisjes lokale (neni 11).

Pjesa e dytë u dedikohet : marrjes së detyrimeve nga ana e nënshkruesëve (neni 12); kujt pushteti i dedikohet, Konventa (neni13) dhe sjellja e informatave (neni 14).

Pjesa e tretë e rregullon materien e : nënshkrimit, ratifikimit, hyrjes në fuqi (neni 15); klauzola territoriale (neni 16); tërheqja (neni 17) dhe informimi (neni 18).

Preambula i thekson premisat themelore në të cilat bazohet preambula, ndërsa para së gjithash rëndësinë vitale të vetëqeverisjes lokale, demokracisë, rolit kryesor të pushtetit lokal në konstruktimin e Evropës bashkëkohore si dhe nevojës së konstituimit demokratik të pushtetit të vetëqeverisjes lokale që gëzon autonomi të gjerë.

Konventa kërkon garantimin ligjor të vetëqeverisjes lokale, ndërsa ku është e mundur edhe kushtetues. Kontrolli komparativ i sistemeve politike në kornizat europiane zbulon se vetëqeverisja lokale në një numër të vogël të vendeve në mes tjerash edhe vendi ynë është *materia constitutionis*. Mendohet për ndjenjë për realitet dhe pragmatizëm.

Neni 3 flet për tiparet esenciale të vetëqeverisjes lokale. Që të jetë e “drejtë” dhe e “vërtetë”, ndërsa të mos jetë agjunkturë e pushtetit më të lartë, pushteti lokal duhet të ketë fushë të kompetencave që është në gjendje t’i kryej dhe të përgjigjet për to. “Krijuesit” në Konventë qëllimisht u shmangen shprehjeve “punë lokale” dhe “punë personale” për rëndësinë ambivalente dhe problemet e interpretimit. Ato nuk duan të kufizohen në punët që nuk kanë implikacione më të gjera që të mos e marginalizojnë vetëqeverisjen lokale nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër janë të rezervuar në kompetencat e caktuara për pushtetin qendror. Fleksibiliteti është tipar i pikës 2 të nenit 3 në të cilën promovohet pushteti demokratik konstituiv lokal, gjegjësisht organit përfaqësues lokal dhe përgjegjës para egzekutivës. Kuptohet pushteti përfaqësues nuk i derogon format e demokracisë direkte.

Krijuesit e Konventës nuk lëshohen në enumerimin e kompetencave të pushtetit lokal. Por për shkak të precizitetit juridik dhe përcaktimit ato nuk kënaqen me *ad hoc* kompetenca të përcaktuara por angazhohen për të drejta themelore juridike. Duke u nisur nga kornizat juridike të disa vendeve europiane, kuptohet, stimulojnë edhe mundësi për delegimin e kompetencës. Pika 2 e nenit 4 garanton prezuncion të kompetencës në favor të pushteteve lokale duke i trajtuar si entitete politike. Paragrafi 3 i nenit 4 e artikulon parimin e decentralizimit në frymën e përfundimeve të konferencës së Lisbonës të ministrave europian, përgjegjës për vetëqeverisjen lokale nga viti 1977. Prioritet në kryerjen e punëve publike kanë organet lokale si më të afërta me qytetarët. Në paragrafin 4 nga neni 4 që të shmanget ngatërresa e kompetencave si dhe rreziku nga ndarja e të njëjtave vërtetohet se të drejtat e pushteteve lokale janë të tërësishme dhe të jashtëzakonshme. Kuptohet që veprimi komplementar në shkallë të ndryshme është e nevojshme në disa sfera edhe në asi rastesh intervenimi eventual i pushtetit qendror ose regjional patjetër duhet të jetë në suazat ligjore. Edhe në kompetencat e përcjella të organeve lokale i lihet liria në adaptimin e realizimit të rrethanave konkrete lokale. Kuptohet jo gjithëmonë fshehtësia lokale është e lejuar (p.sh. me letërnjoftimin). Paragrafi i fundit u dedikohet punëve që nuk janë lokale por e prekin pushtetin lokal. Në atë rast pushtetet lokale do të konsultohen në mënyrë dhe kohë që do t’u mundësojnë ta shprehin mendimin dhe ndikimin.

Kufijtë e njësive lokale janë me rëndësi të jashtëzakonshme për pushtetet lokale dhe për qytetarët të cilëve u shërbejnë. Mu për atë është e nevojshme paraprakisht në mënyrë direkte dhe indirekte të konsultohen qytetarët. Kuptohet, referendumi në atë rast është instrumenti më adekuat por mungesa e tij nga rregullativa juridike në shumë vende është pengesë për mundësin që të zbatohen edhe format e tjera të konsultimit.

Neni 6 në kuadër të parimeve të përgjithshme ligjore për organizimin e administratës, pushteteve lokale u garanton strukturë administrative lokale të tyre, e

adaptuar për nevojat dhe intresat lokale. Kuptohet për angazhimin e kuadrit të aftë janë të nevojshme kushte adekuate, trajnim, shpërblime dhe mundësi për përparim.

Funksionarët e zgjedhur , në frymën e nenit 7, për kryerjen e funksioneve nuk guxojnë të jenë të penguar nga askush, as në aspektin financiar që dmth është i nevojshëm kompenzimi financiar për angazhimin e tyre politik, kompenzim për fitimin e humbur, si dhe sigurim adekuat social. Paragrafi 3 i nenit 7 flet për nevojën e rregullimit juridik të inkompatibilitetit të funksionit – funksionarë lokal me funksione të tjera, por me rregulla të vërtetuara të pashkruara juridike.

Neni 8 i dedikohet mbikqyrjes ndaj organeve lokale nga ana e niveleve më të larta në të ashtuquajturën tutelë administrative që më shpesh realizohet nëpërmjet të pëlqimit paraprak ose me vërtetim të akteve veç më të sjella, kontrollit financiar dhe ngjashëm. Kuptohet e njejta patjetër të jetë juridikisht e themeluar dhe jo *ad hoc* dhe e fshehtë. Rregullë është që të vlerësohet kushtetutshmëria dhe ligjshmëri në punën e pushteteve lokale. Në kompetencat e deleguara megjithatë , organi më i lartë mund t'a vlerësojë edhe përshtatshmërin e zbatimit. Në paragrafin 3 të nenit 8 inagurohet parimi i “përpjesëtueshmërisë” të mënyrës së aplikimit të kontrollit me interesin që mbrohet, gjegjësisht me rezultatin që dëshirohet. Në të kundërtën dmth në rast të “përpjesëtueshmërisë” pushtetet lokale kanë të drejtë në mbrojtje juridike.

Thelbi i nenit 9 nga konventa është se vetëqeverisja lokale është deklaratë e rëndomtë poqese pas kompetencës së garantuar nuk qëndrojnë burime financiare me të cilat pushtetet lokale disponojnë pavarësisht. Paragrafi 2 nga neni 9 e thekson parimin e adekuatshmërisë të mjeteve të detyrimeve, gjegjësisht raportin përkatës mes burimeve të arritshme të të ardhurave dhe detyrave që duhet të realizohen në pajtim me kushtetutën dhe ligjin. Paragrafi 3 i nenit 9 duhet t'u sigurojë liri fiskale të caktuar pushteteve lokale në kuadër të limitit të përcaktuar ligjor të tatimeve dhe kompenzimeve për dhënien e shërbimeve publike. Ndryshueshmëria dhe elasticiteti i burimeve mundëson adaptibilitetë të ndryshimeve ndaj faktorëve ekonomikë. Kuptohet barazimi financiar është masë që zbatohet thujse në të gjitha vendet për shkak të fuqisë së ndryshme financiare të njërive të vetëqeverisjeve lokale dhe të mos mundësohet kufizimi faktik i të drejtave të të “varfërve”. Konventa kërkon konsultim përkatës të pushteteve lokale në procedurën për redistribuim të burimeve të mjeteve. Që të mos rrezikohet e drejta e diskrecionit të pushteteve lokale që të udhëheqin politikë personale. Paragrafi 7 i nenit 9 preferon shmangien e mjeteve të dedikuara dhe preferon blok grante. Pushtetet lokale si persona juridik patjetër të kenë hyrje të lirë në tregun e kapitalit në të cilin, në kuadër të ligjit do të mund të tregohen si nikoqir të mirë. Neni 10 e garanton të drejtën e bashkëpunimit dhe lidhjes të pushteteve lokale, të drejtën e kooperacionit ndërkombëtar dhe anëtarësimin e asociacionit lokal dhe ndërkombëtar.

Së fundi, neni 11 inaguron të drejtën e mbrojtjes juridike të vetëqeverisjes lokale. Në pjesën e dytë, duke u nisur nga realiteti i sistemeve të ndryshme juridike dhe modeli i vetëqeverisjes lokale, nga vendet anëtare të Këshillit të Evropës kërkohet të miratojnë “ nukleusin e domosdoshëm ”nga së paku 20 paragrafe nga pjesa i e Konventës, nga të cilët 10 janë të bazuara në vetëqeverisjen lokale (neni 2, neni 3, paragrafi 1 dhe 2; neni 4, paragrafi 1, 2 dhe 4 , neni 5, neni 7, paragrafi 1 ,

neni 8, paragrafi 1 dhe 2 dhe 3; neni 10, paragrafi 1 dhe neni 11). Neni 13 përcakton se parimet e konventës u dedikohen të gjitha kategorive të pushteteve lokale (komunë, rrethinë , regjion) me mundësi , për shkak të statusit specifik (p.sh. në regjione të caktuara me rregullim federativ shtetëror ose krejtësisht e kundërta në bashkësi të caktuara lokale minore, vendi nënshkrues t'i përjashtoj të njejtat nga ndarja nën Konvent. Neni 14 ka intencë që të hapi derën e vëzhgimit të zbatimit të Konventës. Në mungesë të organit special, të posaçëm që është përgjegjës për supervision, implementohet detyrimi i informimit ligjor dhe mjetet e tjera që merren në vendin-anëtar, ndërsa e prekin edhe vetëqeverisjen lokale. Duhej të kalohet një periudhë e gjatë për kundërshtimin e instrumentit ndërkombëtar që vetëqeverisja lokale të kalohej dhe të miratohej Konventa. Monitoringu i deri tashëm është fleksibil dhe joburokratik, jo shumë i formalizuar dhe institucionalizuar. Kryhet nëpërmjet grupit punues prej 10 anëtarësh nga tubimi i pushteteve lokale dhe një vëzhgues të Tubimit të regjioneve, si dhe nga Komiteti i ekspertëve të pavarur të emëruar nga Sekretariati me pëlqim të Byros dhe Kongresit. Superveizioni i deri tanishëm kishte natyrë politike dhe ishte orientuar kah bashkëpunimi me qeveritë e vendeve anëtare. Zbatohen du metoda të supervizionit “ ex officio” dhe "me kërkesë", dmth aksion që është i inicuar nga pushtetet lokale ose regjionale (rasti me suspendimin e kryetarëve të bashkive nga ana e prefektëve, i inicuar nga federata e komunave të Romanisë dhe Asociacioni i kryetarëve të Këshillave të rretheve të Romanisë në vitin 1994 ose rasti me “tutored e pushtetit qendror të Turqisë ndaj atij lokal” nga viti 1996 ose rasti Italian “relativisht numër i madh i funksionarëve të ndëmar që më parë ishin të zgjedhur” nga viti 1991). Te “supervizioni me kërkesë“ formohen ad hoc grupe, të cilët nëpërmjet bisedave, bashkëbisedime dhe preferimeve tentojnë ta tejkalojnë problemin. Në “supervizionin me thirrje “ hyn edhe rasti i mbylljes së kryetarëve të bashkive maqedonas, kur ad hoc grupi suprvizore e vizitoi Republikën e Maqedonisë, përgatiti raport dhe të njëjtin ia propozoi Kongresit. Diskutimet për përparimin e metodave , ndryshimin e karakterit, institucionalizimin e mbikqyrjes dhe krijimin e kornizës më të sigurt juridike – në kuptim të protokollit plotësues eventual të konventës , është në rrjedhë e sipër. Megjithatë duket se shtetet anëtare gjithënjë e më shumë mbështeten në sistemin supervisor të njëjtë me atë të Konventës sociale, se sa te Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut. Natyra e Konventës si akt dhe natyra e vetëqeverisjes lokale si institucion që nuk duron uniformim janë inkompatibile me modelin gjyqësor të supervizionit.

3. Vetëqeverisja lokale në R. e Maqedonisë.

3.1. Koncepti kushtetues

Vetëqeverisja lokale e Republikës së Maqedonisë është materie kushtetuese.² Ajo është vlerë themelore e rregullimit kushtetues.³ Në pjesën e pestë të Kushtetutës me titullin “ Vetëqeverisja lokale “, parimisht është e vërtetuar pozita e saj kushtetuese në sistemin politik të Republikën e Maqedonisë.⁴ Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, kushtetuta ua garanton të drejtën e vetëqeverisjes lokale , duke e vërtetuar karakterin demokratik të vetëqeverisjes lokale.⁵

Kushtetuta e vitit 1991 inauguron vetëqeverisje lokale në shkallë të parë. Qyteti i Shkupit është i përcaktuar si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale, ku organizimi i saj rregullohet me ligj. Gjithashtu, Kushtetuta lejon themelimin e formave të ndryshme të vetëqeverisjes vendore.

Me metodën e enumeracionit pozitiv parimor, Kushtetuta i përcakton fushat themelore që përfshihen në kompetencat komunale, duke i garantuar edhe burime të të ardhurave personale, si edhe mjete republikane për realizimin e tyre. Kuptohet, kompetenca e përcaktuar kushtetuese nuk është përfundimtare, por mund të plotësohet me ligj. Bëhet fjalë për të ashtuquajturat kompetenca burimore në kryerjen e të cilëve komuna gëzon pavarësi, ndërsa mbikqyrja shtetërore shtrihet nën ligjëshmërin e punës.

Koncepti kushtetues i vetëqeverisjes lokale e thekson demokracinë direkte në procesin e vendosjes në nivel lokal (kombinim i formave të demokracisë direkte dhe përfaqësuese).

Rëndësia e veçantë e vetëqeverisjes lokale për demokracinë maqedonase del nga imperativi kushtetues, normat kushtetuese për vetëqeverisjen lokale që operacionalizohen me sistem ligjor për vetëqeverisje lokale që silltet me dy të tretat e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve , me çka në frymën e Marrëveshjen kornizë nga viti 2001 dhe amandamenti i XVI i kushtetutës së RM, është e nevojshme edhe shumica e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët i përkasin bashkësisë e cila nuk paraqet shumicë në RM. Procedura e tillë etnike e veçantë zbatohet edhe gjatë sjelljes së ligjeve për financimin lokal, zgjedhjet lokale , kufijtë e komunave dhe për qytetin e Shkupit .

² Në frymën e Konventës Evropiane për vetëqeverisje lokale më saktë neni 2 nga konventa që thotë : “Parimi i vetëqeverisjes lokale përcaktohet me ligdhënien e çdo vendi kontraktues, atje ku nuk është e mundur me kushtetutë.”

³ Neni 9 alineja 9

⁴ Nga neni 114-117

⁵ Neni 114 paragarfi 1

3.2 Ligji për vetëqeverisjen lokale

3.2.1 Statuti i komunës

Për pozitën e komunës si njësi e vetëqeverisjes lokale është kryesore definicioni ligjorë për komunën si “ bashkësi e banorëve të një rrethi të caktuar të vërtetuara me ligj, e cila nëpërmjet të organeve, administratës dhe shërbimeve organizative publike të saj, mundëson kryerjen e kompetencave të shkruara me ligj”⁶.

Ligji për vetëqeverisje lokale (LVL), gjithashtu I garanton komunës subjektivitet juridik, duke e vërtetuar në nenin 3 paragrafi 2 se “komunat janë persona juridikë”.

Popullata e komunës lidhet me vendbanimin e përhershëm në rrethin e komunës (neni 6 nga LVL).

Komuna ka rrethinën dhe emrin e saj të vërtetuara me ligj. Rrethina është parakusht dhe tipar kryesor i komunës, ndërsa emri e identifikon secilën komunë.

Stema dhe flamuri janë simbolet e komunës. Ligji kërkon që stema dhe flamuri i komunës të dallohen nga stema dhe flamuri i Republikës së Maqedonisë, si edhe nga stemat dhe flamujt e komunave të tjera ose të Qytetit të Shkupit. Në pajtueshmëri me normat ndërkombëtare, stema dhe flamuri i komunës patjetër duhet të dallohet nga stema dhe flamuri i shteteve të tjera, nga komunat e shteteve të tjera dhe nga organizatat ndërkombëtare. Simbolet e njësisive të vetëqeverisjes lokale mund të shfrytëzohen pas regjistrimit në Regjistrin e stemave dhe flamujve të komunave, që udhëhiqen nga Ministria e vetëqeverisjes lokale. Mënyra dhe procedura për vërtetimin e stemës dhe flamurit të komunës rregullohen me Statutin e saj.

Statuti është akt themelor juridik i komunave dhe i Qytetit të Shkupit si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale. Me statut rregullohet : organizimi dhe puna e organeve të komunës; përbërja, zgjedhja dhe funksionimi i grupeve punuse të këshillit; mënyra e informimit të qytetarëve; procedura për dërgimin e propozimeve dhe parashtrësive; zbatimin e anketave dhe organizimin e tribunave etj.

3.2.2. Themelimi dhe vërtetimi i teritoreve të komunave

Komuna nuk është shpikje dhe kreacion administrativë i shtetit. Ajo është tërësi socio-ekonomike, politike, kulturore dhe ekologjike në të cilën qytetarët mund

⁶ Neni 2 paragrafi 1 pika 1 nga Ligji për vetëqeverisje lokale (LVL)

ta realizojnë të drejtën e vetëqeverisjes lokale dhe duke mbrojtur karkterin demokratik të vetëqeverisjes lokale.

Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale “ Komuna themelohet për territor të një ose më shumë vendeve banuese ku qytetarët janë të lidhur me nevoja dhe interesa të përbashkëta dhe në të cilën ekzistojnë kushte për zhvillimin material dhe shoqëror dhe për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendosjen e nevojave dhe interesave lokale” (neni 16 nga LVL).

Gjatë përcaktimit të territorit të komunës ligjdhënësi duhet të niset nga kriteri objektiv (neutral). Pikërisht, territori duhet të paraqesë “tërësi natyrore gjeografike me komunikacion në mes të vendeve të banuara dhe gravitimit nga qendra e përbashkët, si edhe të ketë objekte të infrastrukturës dhe objekte të standardit shoqëror” (neni 17 nga LVL).

Organizimi territorial i Republikës së Maqedonisë Vërtetohet më ligj të posaçëm.

3.2.3. Kompetencat e komunës

Ligji për vetëqeverisje lokale me kompetencë nënkupton “ përmblendhje të punëve me interes publik dhe me rëndësi lokale të cilët komuna , në pajtim me ligjin , ka të drejtë t’i kryejë në territorin e saj dhe është përgjegjëse për kryerjen e tyre”(neni 2 paragrafi 1 pika 6 nga LVL).

Gjatë përcaktimit të “kompetencave të përgjithshme” ligjdhënësi niset nga parimi I supsidiaritetit, sipas të cilit “ komunat kanë të drejtë në territorin e tyre t’I kryejnë punët me interes publik të rëndësisë lokale, që nuk janë të përjashtuara nga kompetenca e tyre ose nuk janë në kompetencat e organeve të pushtetit shtetëror”(neni 20 nga LVL).

Në frymën e Konventës Evropiane për vetëqeverisje lokale, Ligji vërteton tri parime themelore të lidhura me kompetencat e komunave. Sipas parimit të parë, komunat janë të pavarura në rregullimin dhe kryerjen e punëve me interes publik të rëndësisë lokale, të përcaktuara me Ligj dhe janë përgjegjëse për kryerjen e tyre. Sipas parimit të dytë, gjatë përcaktimit ligjor të kompetencave të tjera përcaktohen edhe burimet për financimin e tyre. Sipas parimit të tretë, kompetencat e komunave të përcaktuara me ligj me të drejtë janë të tërësishme dhe me përjashtime dhe nuk guxojnë të merren ose kufizohen, përveç në rastet caktuara me ligj (neni 21 nga LVL).

Ligji për vetëqeverisje lokale përmban listë të gjatë dhe detale të kompetencave burimore : planifikimi urbanistik; mbrojtja e ambientit jetësor dhe natyror; zhvillimi ekonomik lokal, veprimet komunale; kultura ; sporti dhe rekreacioni; mbrojtja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve; arsimi; sigurimi primar shëndetësor; zbatimi i përgatitjeve dhe ndërmarrja e masave për mbrojtjen dhe shpëtimin e qytetarëve dhe të mirave materiale nga shkatërrimet luftarake, fatkeqësive të ndryshme natyrore; mbrojtja kundër zjarrit; mbikqyrja në kryerjen e punëve të kompetencave të tyre dhe punë të tjera të parapara me ligj.

Edhe pse LVL nuk bën klasifikime në kompetenca të domosdoshme dhe fakultative , në nenin 21 paragrafi 3 thuhet se :” Me ligj përcaktohen të gjitha punët që janë në kompetencë të komunave të cilët ajo domosdo do t’i kryejë’.

Përveç kompetencave të ashtuquajtura burimore dhe të pavarura,, LVL parimisht e operacionalizon dispozitën kushtetuese për kompetencë të deleguar. Së pari, punohët për delegim të kryerjes së punëve të caktuara nga organet e administratës shtetërore të kryetarit të bashkisë në pajtim me ligjin. Së dyti, delegimi i kompetencave duhet të jetë i përcjellë me transferimin e mjeteve financiare për kryerjen e tyre. Së treti, në suazat e standardeve të paracaktuara me ligj, egzekutimi i kompetencave të deleguara komuna mund t’i përshtasë me kushtet lokale. Dhe, së tertri organi i administratës shtetërore është përgjegjës për kryerjen e punëve të deleguara.

Në kryerjen e punëve të kompetencave të saj, komunat mund të themelojnë shërbime publike në pajtim me ligjin. Gjithashtu , përcaktohet mundësia për kryerjen e punëve të deleguara nga kompetenca komunale në persona juridikë dhe fizikë, në bazë kontratës të përbashkët për kryerjen e punëve nga interesi publik, në pajtim me ligjin. Kuptohet, komuna mbetet përgjegjëse për punën të cilin ekzekutiva ia delegon.

3.2.3. Pjesëmarrja direkte e qytetarëve në vendimin e komunës

Ligji për vetëqeverisje lokale parasheh tri forma të demokracisë direkte : iniciativa qytetare; tubimi i qytetarëve dhe referendumi. Shpenzimet për zbatimin e tyre mbulohen me buxhetin komunal.

Iniciativa qytetare përbëhet në të drejtën që qytetarët t’i propozojnë këshillit të komunës sjelljen e aktit të caktuar ose zgjidhjen e çështjeve të caktuara nga kompetencat e saj. Ligji e përjashton iniciativën e qytetarëve për çështje kadrovike dhe financiare. Për iniciativën qytetare këshilli është i detyruar të debatojë nëse atë e përmbajnë 10% nga zgjedhësit e komunës edhe atë në afat prej 90 ditësh, si edhe t’i lajmërojë inisiatorët për sjelljen e vendimit .

Tubimin e qytetarëve e thirr prefekti me iniciativë personale, me kërkesë të këshillit ose me kërkesë të së paku 10% të zgjedhësve të komunës, gjegjësisht vetëqeverisja vendore. Organet komunale kanë detyrë në afat prej 90 ditësh ti shqyrtojnë konkluzionet e sjellura në tubim, t’i marrin parasysh gjatë sjelljes së vendimeve, si edhe t’i informojnë qytetarët për vendimet e sjella.

Këshilli i komunës është i detyruar të shpallë referendum kur atë e kërkojnë 20% e zgjedhësve (referendum i domosdoshëm), ndërsa mund të shpallë referendum edhe për çështje nga kompetencat e saja (referendum fakultativ). Rezultatet e referendumit janë të domosdoshme për këshillin (neni 28 paragrafi 4 nga LVL).

Për përforcimin e funksionit të shoqërisë civile dhe përgjegjësisë së pushtetit publik, LVL përmban dispozita për të drejtën e qytetarëve të dërgojnë parashtrësira

dhe propozime për punën e organeve të administratës komunale, si edhe për detyrimin e organit përkatës t'i japë përgjigje me sqarim parashtruesit, më vonë në afat prej 60 ditësh nga dita e parnimit. Në rast së punohet për çështje që nuk janë në kompetencat e komunës, organi komunal është i detyruar t'a dërgojë të njëjtën deri te organi kompetent dhe ta lajmërojë parashtruesin për këtë.

Gjatë përgatitjes së dispozitave këshilli i komunës dhe prefekti mund të organizojnë tribuna publike dhe anketa.

3.2.5. Organizimi dhe puna e organeve të komunës

Organet e komunës sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale janë këshilli dhe prefekti (neni 31 nga LVL).

3.2.6. Këshilli i komunës ⁷

Këshilli është trup përfaqësues i qytetarëve. E përbëjnë nenet 9-33, varësisht nga numri i banorëve të komunës. Anëtarët e këshillit zgjidhen me zgjedhje të përgjithëshme, direkte dhe të lira, me votim të fshehtë. Ato i prezantojnë qytetarët, vendosin me bindje personale dhe nuk mund të revokohen (mandat i lirë).

Këshilli është kompetent për punët më të rëndësishme për zhvillimin e komunës : për sjelljen e statutit, buxhetit, llogarisë vjetore dhe dispozitave të tjera; për vërtetimin e lartësisë së burimeve të të ardhurave personale në suazat e vërtetuara ligjore; për formimin e shërbimeve publike dhe për mbikqyrjen e punës së tyre dhe llogarisë së tyre vjetore; për zgjedhjen e udhëheqësit të njësisë territoriale në Ministrinë për punë të brendshme.

Këshilli nga përbërja e tij formon komisione të përkohëshme dhe të përherëshme. Punon me mbledhje, ku për mbajtjen e së cilës është e nevojshme prezenca e shumicës nga numri i përgjithshëm i anëtarëve. Vendimet sillen me shumicë votash nga pjesëmarrësit (shumicë relative), në rast se me Ligjin ose me statutin nuk është e rregulluar ndryshe. Me të drejtë votohet publikisht. Kur bëhet fjalë për dispozita nga kultura, përdorimi i gjuhëve dhe shkrimeve që e flasin më pak së 20% nga qytetarët në komunë, përcaktimin dhe shfrytëzimi i stemës dhe flamurit të komunës, përveç shumicës së votave nga anëtarët prezentë, është e nevojshme edhe shumica e votave nga anëtarët prezentë që janë pjesëtarë të bashkësive që nuk janë shumicë në komunë.

Të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të këshillit janë : të marrin pjesë në punën e këshillit dhe të trupave punuese, të japin propozime dhe inisiativa, si edhe t'i parashtrojnë pyetje prefektit.

Anëtarët e këshillit gëzojnë imunitet. Ato nuk mund të thirren në përgjegjësi penale ose të paraburgosen për mendimin e shprehur ose për votimin në këshill.

⁷ Neni 31-49 nga LVL

Mandati i anëtarëve të këshillit është katër vjet. Ai ndërpritet me fuqi të Ligjit edhe para skadimit të afatit, nëse anëtari jep dorëheqje, nëse vdes; nëse është i dënuar me aktgjykim të plotëfuqishëm për vepër penale me dënim burg me kohëzgjatje mbi 6 muaj; në rast të moslidhjes së funksionit sipas Ligjit për zgjedhjet lokale; nëse me vendim të plotëfuqishëm i është hequr aftësia e punës; si edhe kur i ndërpritet banimi në komunë.

Anëtarit të këshillit mund ti merret mandati nëse mungon pa arsye në tri mbledhjet e këshillit. Vendimi për marrjen e mandatit sillet me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit.

Këshilli mund edhe të vetlëshohet, nëse për atë deklarohet shumica nga numri i përgjithshëm i anëtarëve. Me fuqi të Ligjit këshilli lëshohet nëse : për së dyti e sjell dispozitën që më parë ka qenë e anuluar dhe e ndërprer nga Gjygi Kushtetues i RM; nëse sjell vendim me të cilin rrezikohet sovraniteti dhe integriteti territorial i RM; nëse nuk mblidhet në periudhë më gjatë së 6 muaj dhe nëse nuk e sjell buxhetin dhe llogarinë vjetore të buxhetit deri me 31 mars të vitit vijues.

Deri në zgjedhjen e këshillit të ri punët e tij i kryen prefekti i komunës. Ai nuk mund të vendosë për: për çështjet në lidhje me përdorimin e pronësinë komunale, si edhe për çështje në të cilat ai ose bashkëshorti(ja), fëmijët ose farefisi deri në vijën e brezit të dytë anësor, kanë interes financiar apo interes tjetër. Prefekti nuk mund të sjellë dispozita që janë në kompetencat e Këshillit.

Me mbledhjet e këshillit udhëheq kryetari, i cili zgjidhet nga rendi i anëtarëve, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve, për periudhë prej 4 vitesh. Kryetari i thirr dhe i udhëheq mbledhjet e këshillit; kujdeset për organizimin dhe punën e këshillit; i nënshkruan dispozitat e sjella në këshill dhe i'a dërgon prefektit për shpalljen në afat prej tri ditëve nga sjellja.

3.2.7. Prefekti ⁸

Ligji për vetëqeverisje lokale i vitit 2002 parashef pushtet ekzekutiv monocefal. Prefekti, si organ inokos ekzekutiv, ka kompetenca të gjera dhe kryesore. Ai e paraqet dhe përfaqëson komunën, e kontrollon ligjshmërinë e dispozitave të këshillit, i shpall dispozitat e këshillit në gazetën zyrtare komunale, e siguron zbatimin e vendimeve të këshillit , udhëheq me administratën komunale, e siguron zbatimin e punëve të cilat me Ligj i janë të deleguara komunës, inicon dhe propozon sjelljen e dispozitave që janë në kompetencë të këshillit, e propozon buxhetin vjetor, llogarinë vjetore të buxhetit, e zbaton buxhetin , zgjedh drejtorë në shërbimet publike të themeluara nga komuna, vendos për punë administrative për të drejtat , detyrimet dhe interesat e personave juridikë dhe fizikë në pajtim me ligjin etj.

Statusi i prefektit del nga mënyra direkte e zgjedhjes së tij. Funkzioni i prefektit është profesional. Në rast mungese ose pengese, ai vendos kush prej

⁸ Neni 49-54 nga LVL.

anëtarëve do ta zëvendësojë. LVL thotë se kryetari i këshillit nuk mund t'a zëvendësojë prefektin (neni 52 paragrafi 6).

Prefekti gëzon imunitet, gjegjësisht nuk mund të thirret në përgjegjësi penale ose paraburgim për mendimin e thënë në këshill.

Mandati i prefektit është katër vjet. i njëjti mund t'i ndërpritet më herët, nëse jep dorëheqje, mëse vdes, nëse me aktgjykim të plotëfuqishëm është i dënuar për vepër penale më dënim burg mbi 6 muaj, me vendim të plotëfuqishëm i është marrë aftësia e punës, nëse vjen në moslidhshmëri të funksionit sipas Ligjit për zgjedhje lokale dhe në rast të mungesës pa arsye më shumë se 6 muaj ose kur i ndërpritet banimi në komunë. Arsyetimin e mungesës e vlerëson këshilli i komunës, me dy të tretat e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

LVL nga viti 2002 e rregullon edhe konfliktin e interesave të prefektit, duke theksuar se : prefekti nuk mund të emërohet për anëtar të organeve kontrolluse, administrative dhe mbikqyrëse të shoqatave tregtare dhe shërbimeve publike, nuk mund të marrë pjesë në vendimin e çështjeve ku ai ose bashkëshorti(ja) e tij, fëmijët ose farefisi i vijës së dytë anësore, kanë interes financia ose interes tjetër.

3.2.8. Komisioni për marrëdhënie midis bashkësive

LVL i vitit 2002 parasheh formimin e komisioneve për marrëdhënie midis bashkësive të komunave në të cilat së paku 20% nga numri i përgjithshëm i banorëve janë pjesëtarë të bashkësive të cilët nuk janë shumicë në komunë. Ai formohet sipas përfaqësis paritetike të bashkësive. Komisioni i shqyrton çështjet nga marrëdhëniet ndëretnike dhe jep mendim dhe propozime për zgjedhjen e tyre. Këshilli i komunës është i detyruar t'i shqyrtojë dhe të japë vendim për to.

3.2.9. Administrata komunale

Administrata komunale i kryen punët e kompetencave të komunës. Ajo organizohet me sektor dhe klasa. Komuna mund të formojë edhe inspektorat komunal për mbikqyrje mbi punën komunale.

Gjatë punësimit, në administratën komunale dhe në shërbimet publike ku themelues është komuna, sipas nenit 59 nga LVL, duhet të respektohet parimi i përfshirjes përkatëse dhe të drejtë të qytetarëve të cilët u takojnë të gjithë bashkësive, si edhe kriteri për profesionalizëm dhe kompetencë (neni 59 nga LVL). Të punësuarit që kryejnë punë profesionale, normative – juridike, ekzekutive, administrativo – mbikqyrëse dhe zgjedhin punë administrative kanë status të nëpunësit shtetërorë. Për ato vlejnë dispozitat nga Ligji për nëpunësit shtetërorë.

Për të punësuarit në administratën komunale të cilët kryejnë punë administrativo-teknike dhe ndihmëse zbatohen dispozitat nga ligjshmëria punuse.

Administrata komunale : i përgatit aktet për këshillin dhe prefektin, si edhe mbledhjet e këshillit dhe trupave punuese të tij; kryen punë profesionale për këshillin

dhe prefektin ; i analizon gjendjet në sferata e kompetencave të komunës dhe jep propozime për zgjedhjen e tyre; përgatit dhe dorëzon informata dhe të dhëna për gjendjen dhe aktivitetet në komunë deri në organet kompetente, në kërkesë të tyre ose sipas ligjit; kujdeset për dokumentacionin e komunë etj.

Administrata e përbashkët në LVL nga 2002. Komunat mund të formojnë trupa administrative të përbashkëta në sfera të caktuara , në pajtueshmëri me ligjin. Këto trupa formohen me vendime nga këshillat e komunave – themeluese. Vendimet janë bazë për lidhjen e kontratës me shkrim në të cilën përcaktohen komunat – themeluese, selia, lloji, vëllimi dhe mënyra e kryerjes së aktiviteteve, financimit, kontrolli i punës, mënyra e ndërprerjes. Kontrata shpallet në “ Gazetë zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

3.2.10. Financimi i komunave

Ligji i vetëqeverisjes lokale nga viti 2002 përmban dispozita parimore për burimet e të ardhurave të komunës, duke theksuar se financimi i komunave rregullohet me ligj të posaçëm. Si burime personale të të ardhurave janë paraqitur : tatimet lokale, kompenzimet dhe taksat. Sipas konventës Evropiane për vetëqeverisje lokale, theksohet roli aktiv në komunë në përcaktimin e lartësisë së shkallës së tatimeve, taksave dhe kompenzimeve, në suazat e ligjit.

Komunës i garantohen edhe tatimet e shtetit, si edhe e drejta për ngarkim në tregun e vendit dhe në tregun e jashtëm në pajtim me ligjin.

Komuna ka të drejtë pronësore ndaj sendeve, mjeteve financiare dhe të drejta me të cilat disponon dhe ekomomizon si nikoqir i mirë, në mënyrë të caktuar me ligj. Pronë komunale është edhe prona e shërbimeve publike të themeluara nga komuna.

Komuna është e pavarur në dispozicionin e burimeve të të ardhurave personale (neni 11 paragrafi 6).

LVL nga viti 2002 e potencon nevojën e përputhjes midis kompetencave dhe mjeteve financiare, gjegjësisht kërkon që burimet e të ardhurave të sigurojnë zbatim adekuat të kompetencave. Kompetencat janë deklarative nëse pas tyre nuk qëndrojnë mjete. Për vetëqeverisje lokale nuk është i mjaftueshëm decentralizimi politik. i domosdoshëm është decentralizimi fiscal, burimet e ndryshme elastike financiare.

3.2.11. Mbikqyrja ndaj punës së organeve të komunës

Karakteri i mbikqyrjes varet nga lloji i kompetencës. Kur është në pyetje kompetenca e ashtuquajtur e pavarur, gjegjësisht burimore, mbikqyrja shtrihet mbi ligjshmërinë e akteve dhe veprimeve , si dhe ndaj punës materiale dhe financiare. Te kompetenca e deleguar mbikqyrja zgjerohet edhe ndaj efikasitetit të punës.

Në raste të parapara me ligj është e mundur edhe mbikqyrja paraprake, ku nënkuptohet pajtim me dispozitat e komunës.

Mbikqyrjen ndaj ligjshmërisë së dispozitave të komunës e kryen ministria kompetente për vetëqeverisje lokale. Organet e administratës shtetërore kryejnë mbikqyrje për ligjshmërinë e punës së organeve të komunës. Ministria për financa e kontrollon punën materialo – financiare të komunës. Enti shtetëror për revision është kompetent për revizionin ndaj punës materiale dhe financiare në komunë. Mbikqyrjen ndaj kompetencave të deleguara nga kryen organi i administratës shtetërore, kompetencat e të cilit i janë të deleguara komunëa.

3.2.12. Gjuhët zyrtare në komunë

Sipas Amandamenti V nga Kushtetuta e RM, Ligji për vetëqeverisje lokale vërteton se gjuhë zyrtare në komunë është gjuha maqedone dhe shkrimi i saj i saj qirilik, si edhe gjuhët dhe shkrimi që e shfrytëzojnë së paku 20% nga banorët e komunave. Kur dhe si do të përdoren gjuhët dhe shkrimi në të cilën flasin së paku 20% nga banorët e komunave vendos këshilli i komunës.

3.2.13. Vetëqeverisja vendore

Kreu XII nga LVL i vitit 2002 i dedikohet vetëqeverisjes vendore. Janë të parapara bashkësi urbane , si formë e vetëqeverisjes vendore në qytetet dhe bashkësit vendore dhe vendet e tjera të banuara.

Në statutin e komunës më afër përcaktohen : format e vetëqeverisjes vendore në komunën konkrete, marrëdhëniet me organet komunale, punët që i kryen prefekti mund t'i delegojë te kryetari i këshillit të vetëqeverisje vendore, si dhe mënyra e sigurimit të mjeteve për punët e deleguara etj.

Ligji përmban dispozita të përgjithshme për kompetencën urbane ,gjegjesisht bashkësitë lokale, si shqyrtimi i çështjeve , marrjen e vendimeve dhe përgatitjen e propozimeve për probleme të rëndësishme direkte të përditshme për jetën dhe punën e banorëve.

Në aspet të kornizës institucionale, parashihet mundësia për zgjedhjen e këshillit urban, gjegjesisht të bashkësisë lokale dhe kryetarit të këshillit. Këshilli zgjidhet në tubimet e qytetare të urbanës, gjegjesisht të bashkësisë lokale , në mënyrë dhe procedurë të caktuar me statutin e komunës. Kryetari i këshillit urban ose bashkësia vendore zgjidhet nga radhët e anëtarëve të këshillit me mandat prej 4 vitesh.

Për zgjedhjen, të drejtat dhe detyrimet e kryetarit të këshillit urban ose të bashkësisë vendore zbatohen dispozitat nga Ligji përkatës i zgjedhjes, të drejtat dhe detyrimet e kryetarit të komunës (nenet 47 dhe 48 nga LVL).

Vetëqeverisja vendore ka traditë të gjatë dhe të frytshme në hapësirat e Maqedonisë. Ajo hap mundësi të gjera për kyçjen e qytetarëve dhe inisiativat e tyre në zgjedhjen e çështjeve të lidhura me vendin e banimit.

3.2.14. Bashkëpunimi në mes të komunave, Qeverisë së RM dhe administratës

Organet shtetërore , sipas LVL, janë të detyruara në afat të caktuar dhe në mënyrë adekuate t'i konsultojnë organet komunale kur vendosin për çështje që u dedikohen atyre. Mënyra e konsultimeve përcaktohet me ligjet nga sfera përkatëse. Konsultimet janë të domosdoshme edhe gjatë përgatitjes së planit hapsinor të Republikës(neni 78 paragrafi 20).

Bashkëpunimi zhvillohet edhe nëpërmjet lidhjes së kontratave ndërmjet shtetit dhe komunave. Qeveria, për shkak të kordinimit gjatë planifikimit, programimin dhe implementimin e politikave në sfera të caktuara, mund të lidhë kontrata për bashkëpunim me një ose më shumë komuna, për çka informohet Kuvendi i RM.

Sipas nenit 80 nga LVL, Qeveria është e detyrur të bashkëpunojë me komunat kur sillen ligje që u dedikohen komunave; kur përcaktohet shuma e dotacionit të përgjithshëm që duhet tu ndahet komunave në vitin vijues kalendarik; si dhe për burimin e financave dhe të kompetencave. Më tutje Ligji insiston të përgatitet raport në të cilin do të evidentohen çështjet për të cilat është arritur pëlqim dhe për ato për të cilët nuk është arritur pëlqim.

Gjatë propozimit të ligjit që i prek interesat e komunave ,atij detyrimisht i shtohet raporti i lartpërmëndur. LVL përmban dispozita themelore për Shoqatën e komunave të RM, si institucion për mbrojtje dhe përparim të interesave të përbashkëta të komunave. Duke u nisur nga e drejta e bashkimit të komunave në forma të ndryshme fakultative, në nenin 81 të Ligjit thuhet se shoqata e cila përfshin më tepër së dy të tretat nga komunat në tërë territorin e shtetit ka të drejtë të prezantohet si përfaqësues legjitim i komunave , gjegjësisht të bashkëpunojë më

Qeverinë në emër të tyre, të inicojë sjellje të ligjeve që u dedikohen përparimit të vetëqeverisjes lokale, si dhe të japë propozime për projektimin e propozimit të buxhetit të RM në pjesën që i dedikohet ndarjes së mjeteve të komunave për kryerjen e kompetencave të përcaktuara me ligj. Gjithashtu, shoqata e komunave e RM, në të cilën bëjnë pjesë më tepër se dy të tretatnga komunat e përfaqëson RM në organizatat ndërkombëtare të pushteteve lokale dhe bashkëpunon me organizata të përfaqëruara nga vende të tjera. Themelimi,organizimi, funksionimi dhe regjistrimi i shoqatës rregullohet me ligj të veçantë.

3.2.15. Mbrojtja e vetëqeverisjes lokale

Vetëqeverisja lokale gëzon dy lloje mbrojtjesh : mbrojtje të statusit kushtetues dhe mbrojtje gjyqësore. Këshilli dhe prefekti mund të parashtojnë iniciativë për vlerësim të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve të përgjithshme të ministrive dhe organve të tjera të administratës shtetërore me të cilat shkilet pozita kushtetuese dhe të drejtat e komunës të përcaktuara me kushtetutë dhe ligj.

Komunave u garantohet mbrojtje përpara gjyqeve kompetente në raport me aktet dhe aktivitetet e organeve të administratës shtetërore dhe Qeverisë së RM me

të cilët pengohet kryerja e kompetencave të komunës të përcaktuar me ligj (neni 88 nga LVL).

Mbrojtja e rregulluar me ligj e vetëqeverisjes lokale duhet të mundësojë funksionim të pa penguar të këtij institucioni të rëndësishëm demokratik, në pajtim me parimin e qeverisjes të së drejtës.